

# **RELACION PËR**

## **PROJEKTLIGJIN**

### **“PËR TRAJTIMIN FINANCIAR ME PENSION SHËRBIMI TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT QË NDËRPRESIN MARRËDHËNIET E PUNËS”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për trajtimin financiar me pension shërbimi të punonjësve të Policisë së Shtetit që ndërpresin marrëdhëniet e punës”, ka për qëllim që t’i garantojë punonjësve të këtij institucioni që ndërpresin marrëdhëniet e punës, trajtim financiar me “pension shërbimi”, si përfitim suplementar në përputhje me kuadrin ligjor për sigurimin shoqëror suplementar, si dhe i parashikuar në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, neni 73.

Konkretisht, projektakti synon, që t’i japë mundësi punonjësve të Policisë së Shtetit me një karrierë të gjatë në këtë strukturë, që të përfitojnë pension shërbimi në rast se dëshirojnë që të ndërpresin marrëdhënien e punës përpara plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie.

Nga ana tjetër, propozimet e këtij projektakti synojnë uljen e moshës mesatare të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke siguruar kështu, një polici më aktive dhe efçente në luftën kundër krimit në përgjithësi e atij të organizuar në veçanti, si dhe rritjen e parametrave të rendit e sigurisë publike.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji është pjesë e reformës në Policinë e Shtetit, pasi në programin politik të Këshillit të Ministrave, prioriteti i qeverisë për vitet në vazhdim është rritja e parametrave të rendit e sigurisë publike, forcimi i mëtejshëm i luftës kundër krimit në përgjithësi e atij të organizuar në veçanti, si dhe luftës kundër terrorizmit.

Reforma e plotë në Policinë e Shtetit, do të realizohet nëpërmjet miratimit të të gjithë akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, por dhe nga ky projektakt.

Projektligji është jo vetëm në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuar në nenin 73 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, por edhe në harmoni me nenin 4, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore”, të ndryshuar, si dhe me kuadrin ligjor që rregullon trajtimin me pensione shtetërore suplementare të personave që kontribuojnë në skemën e sigurimit suplementar.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Aktualisht, trajtimi financiar i punonjësve të Policisë së Shtetit, pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, rregullohet sipas ligjit për pensionet suplementare të ushtarakëve (*ligji nr.10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me aktin normativ nr.5/2010*).

Ky ligj, por në veçanti akti normativ që e ka ndryshuar, ka ulur ndjeshëm nivelin e përfitimit të punonjësve të policisë, në raport me përfitimet suplementare që ato kishin deri në vitin 2009, sipas ligjit nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Nga ana tjetër, ligji për pensionin suplementar të ushtarakëve i cituar më sipër nuk parashikon trajtimin e punonjësve të policisë me “Pension shërbimi”, si kategori e re “pension i parakohshëm” e parashikuar për herë të parë në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar (germa c, e nenit 73).

Miratimi i këtij projektligji është i domosdoshëm për faktin se, detyrat institucionale që ligji i ngarkon Policisë së Shtetit, janë të një rrezikshmërie e vështirësie shumë të lartë në raport me detyrat institucionale që kanë strukturat e tjera shtetërore që aktualisht janë subjekte të ligjit për pensionet e ushtarakëve.

Kështu:

- nga viti 1991 dhe në vazhdim kanë humbur jetën në krye të detyrës 223 punonjës policie dhe janë plagosur 248.

- gjatë këtyre viteve ka dhe punonjës policie të vrarë apo plagosur pas ndërprerjes së karrierës nga elementë kriminal, që janë vetëvrasë apo kanë pësuar trauma të rënda psikike/psikologjike për shkak të kryerjes së detyrave të vështira dhe specifike, duke sjellë paaftësinë e tyre për punë në Policinë e Shtetit në një moshë relativisht të re;

- punonjësi i policisë, për vetë natyrën e punës në këto struktura, e ka të limituar periudhën e ushtrimit të detyrave të cilat kërkojnë aftësi të larta fizike dhe rrjedhimisht do të largohen nga strukturat e policisë, para arritjes së moshës për pension pleqërie. Ndërkohë, që punësimi i tyre në shërbimet e tjera publike/private është thuajse i pamundur, pasi mosha dhe arsimimi i tyre ndikojnë ndjeshëm në një mundësi të tillë;

- disa punonjës policie për shkak të nevojave të veçanta të punës, si dhe kur ekziston një situatë reale dhe e rrezikshme ndaj jetës dhe familjes tyre, apo kur për qëllime të zbulimit të krimeve të rënda, infiltrohen në grupe të strukturuar apo organizata kriminale, mund të transferohen jashtë vendbanimit të tyre, gjë që detyron bashkëshortin/en të ndërpresë marrëdhënien e punës. Në këto kushte, me largimin e punonjësit nga policia, familja e tij do të mbetet pa mbështetje ekonomike dhe do të duhet të përballojë jetesën vetëm me pensionin e parakohshëm të tij.

- sikurse përmendur më sipër, shkalla e vështirësisë në punë të punonjësve të Policisë së Shtetit është me e lartë se e punonjësve të institucioneve tjera që janë subjekte të ligjit për pensionin e ushtarakëve, pasi ata përballen çdo ditë me elementë kriminal, kryejnë veprime policore me rrezikshmëri të lartë për jetën e shëndetin e tyre si ndalime/arrestime, kapje të personave të kërkuar dhe operacione policore që kërkojnë jo vetëm përgatitje të lartë fizike, por edhe një moshë relativisht të re.

Nevoja e trajtimit financiar dinjitoz të punonjësit të policisë siç përcaktohet në këtë projektligj, pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, buron edhe nga dispozitat e neneve 46 dhe 49 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet se nëse punonjësi i policisë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërpret marrëdhënien e punës dhe përfiton pension të parakohshëm suplementar apo pension shërbimi, nuk ka të drejtë të rikthehet në

polici. Në nenin 46, pika 3, përcaktohet se punonjësit, të cilit i shkurtohet funksioni organik në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të policisë dhe nuk ka vend të lirë për gradën që mban, i ofrohet një funksion i një niveli më të ulët, duke ruajtur gradën për një periudhë deri në një vit. Pas kalimit të këtij afati, në pamundësi sistemimi për gradën që ka, punonjësi lirohet nga policia dhe duhet të trajtohet sipas kriterëve të përcaktuar në këtë projektligj.

Aktualisht, mosha mesatare e punonjësve të policisë është 45.6 vjeç. Me miratimin e këtij projektligji për një periudhë prej 3 vitesh mosha mesatare e punonjësve të policisë ulet në 44.1 vjeç, pra një ulje mesatare me 1.5 vite.

Projektligji është një garanci për punonjësit e policisë që janë në marrëdhënie pune dhe një vazhdim logjik i statusit të tyre kur ndërpresin karrierën. Miratimi i këtij projektligji do të ndikojë, në cilësinë e punës dhe të performancës së punonjësve të policisë në detyrë, në rezultatet në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, në treguesit e luftës kundër korrupsionit si brenda dhe jashtë policisë, si dhe në objektivitetin e zbatimit të ligjit.

Nisur sa më sipër, projektligji i paraqitur për miratim është në harmoni të plotë me reformën e pensioneve të ndërmarrë nga qeveria, me skemat tjera të sigurimit suplementar për kategoritë e tjera të punonjësve të shtetit, me kontributin real të punonjësve të policisë së shtetit në skemën e sigurimit suplementar dhe në raport të drejtë me kontributin që ata japin për rendin e sigurinë publike dhe luftën kundër kriminalitetit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, neni 73 në të cilin përcaktohet:

*“1. Punonjësi i policisë, që ndërpret marrëdhëniet e punës me Policinë e Shtetit, përfiton: a) pagesë kalimtare; b) pension të parakohshëm suplementar; c) pension shërbimi; ç) pension suplementar pleqërie.*

*2. Trajtimi financiar për rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet me ligj të veçantë”.*

Gjithashtu, propozimet e këtij projektligji respektojnë të drejtat e fituara në koherencë me zhvillimet ekonomike të vendit, parimet buxhetore të financimit të shpenzimeve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si dhe dispozitat ligjore në fushën e menaxhimit dhe kontrollit.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*.**

Projektligji “Për trajtimin financiar me pension shërbimi të punonjësve të Policisë së Shtetit që ndërpresin marrëdhënien e punës”, nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT.**

**Neni 1**, parashikon qëllimin e projektligjit, duke përcaktuar të drejtën për trajtim financiar me pension shërbimi të punonjësve të Policisë së Shtetit, që ndërpresin marrëdhënien e punës.

**Neni 2**, parashikon se përfitues të trajtimit financiar me pension shërbimi sipas këtij ligji, janë punonjësit e Policisë së Shtetit që mbajnë gradë policore dhe që plotësojnë kriteret sipas këtij ligji.

**Neni 3**, parashikon se për përfitimin e pensionit të shërbimit, njihet si vjetërsia shërbimi, vetëm vjetërsia në strukturat e Policisë së Shtetit.

**Neni 4**, përcakton pagën referuese, e cila do të jetë e njëjtë me atë të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 *“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.

**Neni 5**, parashikon se përfitimet nga ky ligj financohen nga buxheti i shtetit. Gjithashtu, ky nen përcakton se llogaritja dhe pagimi i përfitimeve, që rrjedhin nga ky ligj, bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

**Neni 6**, parashikon kriteret e përfitimit të pensionit të shërbimit për punonjësin e Policisë së Shtetit. Sipas kësaj dispozite, punonjësi i policisë, me kërkesën e

tij, fiton të drejtën e pensionit të shërbimit, kur plotëson 25 vite vjetërsi shërbimi në strukturat e Policisë së Shtetit me gradë policore dhe ka mbushur moshën 55 vjeç.

**Neni 7**, parashikon masën e përfitimit të pensionit të shërbimit për punonjësin e Policisë së Shtetit. Sipas kësaj dispozite, masa e pensionit të shërbimit për personat që plotësojnë kriteret e përfitimit, (25 vite vjetërsi shërbimi dhe moshën 55 vjeç), është 65 % (përqind) e pagës mesatare referuese neto dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim mbi 25 vite, masa e pensionit të shërbimit, shtohet me 1 % (përqind) të pagës mesatare referuese neto. Shuma e pensionit të shërbimit është parashikuar të mos kalojë 75 % (përqind) të pagës mesatare referuese neto. Punonjësi i Policisë, që plotëson kriteret përfiton pension shërbimi, pa u trajtuar me pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 dhe ky trajtim vazhdon deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie.

Përfitues të pensionit të shërbimit, **do të jenë vetëm punonjësit** e Policisë së Shtetit, që ndërpresin marrëdhënien e punës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 6.

**Neni 8**, parashikon se periudha e trajtimit me pension shërbimi njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar dhe se kontributi për këto periudha përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet në bazë të pagës mujore sipas së cilës është llogaritur përfitimi mujor, i indeksuar çdo vit me koeficientet e indeksimit të bazës së vlerësuar, por, në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, për efekt të pagesës së kontributeve të detyrueshme.

Në këtë nen është përcaktuar se kur përfituesi i pensionit të shërbimit punësohet, veprohet sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 "*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar. Pra, kur përfituesi i pensionit punësohet në vende të tjera pune, që nuk lidhen me funksionin e tij të mëparshëm, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi bëhet sa një pension bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar.

**Neni 9**, parashikon se pensioni i shërbimit indeksohet dhe se koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 10**, përcakton se përfitimet e njohura nga ky ligj, trajtohen sipas përcaktimeve në nenin 28 të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 "*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar.

**Neni 11**, përcakton se pensionin e shërbimit e përfitojnë çdo vit, për tre vitet e para pas hyrjes në fuqi të ligjit, jo më shumë se 30% e punonjësve të policisë, sipas rregullave dhe procedurave të përcatuara me udhëzim të ministrit të Brendshëm. Nisur nga përlllogaritjet në lidhje me numrin e punonjësve që plotësojnë kriteret për përfitimin e pensionit të shërbimit, është vlerësuar e nevojshme që të përcaktohet për çdo vit kuota e përfituesve me qëllim,

në veçanti:

- shmangien e mungesës së efektivëve të policisë në strukturat policore. Më e rëndësishme është vlerësuar shmangia e mungesës së punonjësve në struktura të veçanta apo të specializuara.
- planifikimin e kuotave në Akademinë e Sigurisë;
- gatishmërinë e plotë të strukturave policore.

në përgjithësi,

- përmbushjen e nevojave të Policisë së Shtetit me funksione organike;
- realizimin me efikasitet të plotë të misionit të Policisë së Shtetit, (ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, parandalimi i veprave penale, identifikimi i autorëve të tyre etj.)

**Neni 12**, parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Projektligji është hartuar nga strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar si dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Ministrinë e Brendshme.

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Numri i punonjësve të policisë që aktualisht plotësojnë kriteret për përfitim të pensionit të shërbimit sipas kriterëve të parashikuara në këtë projektligj është në total 1080 punonjës.

Nisur nga nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sikurse shpjeguar në relacion, është vlerësuar që pensionin e shërbimit do ta përfitojnë çdo vit jo më shumë se 30% e punonjësve që plotësojnë kriteret në këtë projektligj, për të cilët efekti financiar është si më poshtë:

Nr	Emertimi	Nr.pu nonjes ve	paga bruto	Paga Neto	Paga mujore /1 person	Vlera Vjetore
1	- Drejtues i Parë	3	122,000	91,810	64,267	2,313,618
2	- Drejtues	11	118,000	88,598	62,019	8,186,478
3	- Krye Komisar	17	106,000	78,962	55,274	11,275,809
4	- Komisar	16	91,000	68,328	47,830	9,183,283
5	- Nen komisar	47	84,500	63,726	44,608	25,159,025
6	- Inspektor	226	68,500	52,398	36,679	99,472,363
	Shuma	320				155,590,577

Nga përlllogaritjet rezulton se efektet financiare mujore janë në vlerën 12,965,881 lekë.

Projektligji është dërguar për dhënie mendimi Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë shprehur si më poshtë:

### 1. Ministria e Drejtësisë ka dhënë mendimin:

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për trajtimin financiar me pension shërbimi të punonjësve të policisë së shtetit që ndërpresin marrëdhëniet e punës”.



a) *se projektligji njeh vjetërsi shërbimi vetëm vjetërsinë në strukturat e Policisë së Shtetit, ndërsa në pikën 2, të nenit 74, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar si vjetërsi shërbimi njihen edhe vjetërsitë në struktura të tjera, si në strukturat e Gardës së Republikës, Policisë së Burgjeve, të Forcave të Armatosura, SHISH, SHÇBA dhe të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit.*

Lidhur me këtë sugjerim, Grupi i përbashkët i punës i përbërë nga punonjës të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Policisë së Shtetit, ka sugjeruar që përfitimet suplementare të punonjësve të Policisë së Shtetit, të jenë të njëjta me ato të punonjësve të tjerë të sigurisë dhe të trajtohen sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 *“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, **por me përjashtim të Pensionit të Shërbimit**, i cili është i veçantë vetëm për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe është detyrim nga neni 73, i ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 *“Për Policinë e Shtetit”*.

Në projektligj është parashikuar të njihet si vjetërsi shërbimi, vetëm vjetërsia në strukturat e Policisë së Shtetit, sepse në ligjet organike të strukturave të tjera nuk është e përcaktuar që punonjësit e tyre të përfitojnë këtë kategori të re pensioni, gjë e cila nuk na lejon për të bërë barazvlefshmërinë në trajtimin financiar të punës së kryer në Policinë e Shtetit me atë të kryer në institucionet e tjera, kjo për shkak edhe të vështirësisë së shërbimit me risk të lartë rrezikshmërie, në raport me strukturat e tjera.

b) *Se si kusht paraprak i domosdoshëm për përfitimin e pensionit të shërbimit, është ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe më pas plotësimi i kriterëve të përcaktuara në këtë projektligj, ....., si për shembull kur punonjësi deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor sipas ligjit, kërkon vetë të lirohet e të tjera raste të kësaj natyre, ....Gjithashtu ndërprerje e marrëdhënieve të punës konsiderohet lirimi ose përjashtimi nga policia, ... duhet të përcaktohet nëse këtë pension e përfitojnë, përveç personave që lirohen edhe personat që përjashtohen nga strukturat e policisë.*

Lidhur me këtë pretendim, sqarojmë se sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë janë reflektuar në ndryshimet e bëra në nenin 6/1 të projektligjit, ku përcaktohet: “Punonjësi i Policisë së Shtetit, **me kërkesën e tij dhe me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**, përfiton trajtim financiar me pension shërbimi, deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie”. **Pra nuk përfitojnë ato që përjashtohen nga Policia e Shtetit.**

Ndërsa në nenin 11, përcaktohet: “Pensionin e shërbimit sipas këtij ligji do ta përfitojnë çdo vit, jo më shumë se 30% të punonjësve të Policisë së Shtetit, që ndërpresin marrëdhënien e punës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 6.

**Rregullat dhe procedura për paraqitjen e kërkesës nga punonjësi i policisë dhe miratimin e saj, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.**

## **2. Ministria e Financave, ka shprehur mendimet:**

*a) Në vitin 2015 u konkretizua reforma në fushën e pensioneve që siguronte në mënyrë afatgjatë qëndrueshmërinë e skemës së pensioneve. Çdo propozim i ri cenon parimet bazë të kësaj reforme.*

Lidhur me këtë koment, sqarojmë se reforma në fushën e pensioneve duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të kodifikojë dhe unifikojë, të gjithë legjislacionin lidhur me fushën e përfitimeve suplementare.

Në përmirësimet e bëra në vitin 2015, në fushën e trajtimeve suplementare, nuk është përfshirë dhe marrë në konsideratë përcaktimi i bërë në nenin 73, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7. 2014 “Për Policinë e Shtetit”, ku thuhet:

*“1.Punonjësi i policisë, që ndërpret marrëdhëniet e punës me Policinë e Shtetit, përfiton:*

*a)pagesë kalimtare;*

*b)pension të parakohshëm suplementar;*

*c)pension shërbimi;*

*ç)pension suplementar pleqërie.*

**2. Trajtimi financiar për rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet me ligj të veçantë.” Reforma e pensioneve nuk e ka**

**prekur këtë kategori pensioni sepse ky është projektligji i parë i hartuar për këtë qëllim.**

Në zbatim të përcaktimit të ligjit të sipërcituar, është ngritur dhe Grupi i Punës me përfaqësues të Ministrisë së Financave, ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit.

Në ndryshim me draftet e mëparshme ku punonjësit e Policisë së Shtetit do të trajtoheshin veçmas për përfitimet suplementare, në krahasim me institucionet e tjera si të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, si dhe efektet financiare ishin shumë të larta, Grupi i Punës ra dakord që trajtimi suplementar i punonjësve të policisë për: *pagesë kalimtare, pension të parakohshëm suplementar dhe pension suplementar pleqërie, të jetë i njëjtë me institucionet e sipërcituar dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, të trajtohet sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009.*

Ndërsa, trajtimi financiar me *“Pension Shërbimi” i punonjësve të Policisë së Shtetit*, meqë nëse është i veçantë të trajtohet sikurse e përcakton edhe neni 73, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7. 2014 “Për Policinë e Shtetit”, me një ligj të veçantë.

Sa më sipër ky projekt – ligj, jo vetëm nuk cenon parimet bazë të reformës, por përkundrazi, ai është pjesë e kësaj reforme, duke harmonizuar dhe kodifikuar ligjet, si dhe krijon kushte optimale për përfundimin e reformës në Policinë e Shtetit, sidomos për uljen e moshës mesatare.

Përcaktimet në këtë projektligj, janë bërë duke marrë në konsideratë disa faktorë dhe konkretisht:

- Efektet financiare;
- Plotësimin e vendeve të lira që mund të krijohen nga dalja e punonjësve të policisë në pension shërbimi;

- Mundësitë dhe kapacitetet që ka Policia e Shtetit për të rekrutuar punonjës të rinj.

Grupi i Punës duke analizuar faktorët e mësipërm, në draft ka përcaktuar: që në pension shërbimi nuk mund të dalin më shumë se 30% të punonjësve të Policisë së Shtetit, që ndërpresin marrëdhëniet e punës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe plotësojnë kriteret përkatëse, kjo është bërë me qëllim për të ulur efektet financiare dhe për të krijuar mundësimin e rekrutimit të punonjësve për plotësimin e vendeve vakante.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se në Policinë e Shtetit plotësojnë kushtet dhe kriteret me hyrjen në fuqi të ligjit rreth 1080 punonjës policie, nga të cilët mund të dalin në vit në pension shërbimi 30% e tyre, ose 320 punonjës. Nga studimi i kryer rezulton se pas tre viteve, daljet e punonjësve të policisë në pension shërbim do të jenë në nivelin minimal dhe të papërfillshëm (thujse zero), kjo si në efekte financiare apo ato të përballimit me burime njerëzore.

*b) Projekti propozohet me kosto financiare shtesë, minimalisht në masën 156 milion lekë në vit, kosto të paparashikuara në buxhetin e vitit 2018 dhe në vijim....., të jepen përkufizime të qarta të pagës mujore bruto, duke emërtuar çdo element të pagës mujore si dhe mënyrën e përcaktimit të vlerës së pagës bruto”.*

Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se ky projektligj ka qenë pjesë e projektligjit të Policisë së Shtetit, i cili edhe për këtë trajtim, është rënë dakord në Grupet Parlamentare, por në parlament u vendos që të kalojë me ligj të veçantë, sikurse është përcaktuar në nenin 73, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7. 2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Efektet financiare për përfitimet suplementare që ishin pjesë e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, ishin në vlerën 1.669.354 mijë lekë.

Në këtë projektligj efektet financiare janë reduktuar në masën 1.513.763 mijë lekë, duke u parashikuar në vlerën 155.591 mijë lekë, të cilat mendojmë se janë në kufij minimalë të mundshëm dhe të përballeshëm nga buxheti i shtetit.

Për vitin 2019, në projektligj nuk është parashikuar kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Në vijimësi kur të miratohet projektligji do të parashikohen edhe shpenzimet buxhetore sipas viteve respektive, të cilat po të krahasohen me variantin që këto përfitime suplementare do të trajtoheshin me ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, janë në vlera shumë të ulëta.

- c) *Në projektligj dhe në relacion, të jepen përkufizime të qarta të pagës bruto, duke emërtuar çdo element të pagës mujore si dhe mënyrën e përcaktimit të vlerës së pagës bruto.*

**Është marrë në konsideratë sugjerimi për përkufizime të qarta të pagës mujore, duke e reflektuar në nenin 4, “Paga Referuese”, të projektligjit, ku është përcaktuar se: “Përfitimet, që jepen nga ky ligj, llogariten në bazë të pagës referuese, të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Llogaritja e këtij treguesi është i qartë dhe i zbatueshëm, pasi ka vite që zbatohet dhe për llojet e tjera të pensioneve.**

- d) *Ky projektligj bën trajtim specifik për një kategori të veçantë, nga ai i rregulluar me ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009, do të krijonte precedent për kërkesa të tjera me kosto të paparashikuara...*

**Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se në asnjë vend të BE, përfitimet suplementare nuk janë të njëjta për institucione të ndryshme të cilat kanë ndryshime rrënjësore në detyrat që kryejnë dhe në rrezikshmërinë që kanë në kryerjen e tyre, si dhe hartimi i këtij projektligji është detyrim ligjor i përcaktimit të bërë në nenin 73, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7. 2014 “Për Policinë e Shtetit”.**

**Në pikën 1, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit” përcaktohet: “Punonjësi i policisë, për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, ka përparësi në trajtimin financiar”.**

Për më tepër, sikurse sqaruar edhe me sipër detyrat institucionale që i ngarkon ligji, Policisë së Shtetit, janë të një rrezikshmërie shumë të lartë dhe nuk mund të krahasohet me asnjë detyre institucionale që kanë strukturat e tjera shtetërore.

e) *Ky projektligj krijon pabarazi të theksuar mes punonjësve të Policisë së Shtetit që do t'u lindë kjo e drejtë dhe atyre që kanë dalë më parë.*

Lidhur me këtë koment sqarojmë se drafti, është hartuar mbi bazën e parimeve të mos prekjes së të drejtave të fituara më parë, të cilat janë përfituar nga punonjësit e policisë në kohë të ndryshme e me kontribute të ndryshme.

Në projektakt janë ndjekur të njëjta përkufizime e teknike legislative si ajo e ligjit nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

f) *Në përcaktimin e formulës së masës së përfitimit nuk është përdorur logjika e pagës mesatare të ponderuar, mbi bazën e së cilës derdhen kontributet gjatë karrierës, për të siguruar lidhjen e drejtpërdrejtë të kontributit të derdhur me përfitimin.*

**Ky sugjerim është marrë në konsideratë** dhe është reflektuar në nenin 4 dhe në nenin 7, të projektligjit, duke i njësuar me ato të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, të ndryshuar.

g) Në nenin 6 të projektligjit, i cili parashikon se: "Përfitimet që rrjedhin nga ky ligj nuk i nënshtrohen sistemit të tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi", vlerësojmë të mos jetë pjesë e përmbajtjes së projektligjit.

**Ky sugjerim është marrë në konsideratë dhe reflektuar** dhe ky nen është hequr nga përmbajtja e projektligjit.

h) *Projektligji në nenin 8, në mënyrën si është shkruar, sjell probleme në zbatim.*

**Ky sugjerim është marrë në konsideratë,** neni 8 është përmirësuar, duke bërë ndryshimet përkatëse, sipas mendimit të dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

i) Gjithashtu në nenin 9, “*Periudha e sigurimit dhe kontributet*” të këtij projektligji, pika 2, parashikohet se: “Në rastet kur përfituesi i pensionit të shërbimit punësohet në sektorin publik, kontributi nga Buxheti i Shtetit derdhet në nivelin minimal dhe masa e pensionit të shërbimit bëhet sa, ...” Në lidhje me këtë përcaktim është e paqartë, nëse punonjësi, i cili përfiton pension shërbimi, do të përfitojë këtë pension edhe kur punësohet në sektorin privat, apo kufizimi në masën e pensionit të shërbimit është vetëm në sektorin publik.

**Ky sugjerim është reflektuar në pikën 2, të nenit 8 “*Periudha e sigurimit dhe kontributet*” dhe konkretisht është ndryshuar dhe bërë:**

“Kur përfituesi i pensionit të shërbimit punësohet, vepron sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar.